



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2698/18 prot.

Datë 16.12.2025

V E N D I M
Nr. 1867/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anetar
Kreshnik Ternova	Anetar

Në mbledhjen e datës 16.12.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1665/2025, datë 13.11.2025, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62685-09-25-2025, me objekt: “Ndërtim Blloku Paskuqan 2”, me fond limit 107,003,399.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 13.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Ankimues: Operatori ekonomik “Ouen” SHPK me NIPT K175292150 dhe adresë: Lagjja Shemri, Rruga Nacionale Shemri-Kukes Km2, Kukës.

Operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK me NIPT J91915001P dhe adresë, Lagjja Zall - Mner i Ri, Rruga Nacionale Kamez, 1054.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kamëz.
Adresa: Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 13.11.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1665/2025 ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen, për pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Ouen” SHPK dhe operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62685-09-25-2025, me objekt: “Ndërtim Blloku Paskuqan 2”, me fond limit 107,003,399.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 13.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Ouen” SHPK dhe operatorit ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse, për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Ouen” SHPK dhe operatori ekonomik “Almo Konstruksion” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 10309prot., datë 19.11.2025, protokolluar me tonën nr. 2698/10/9 prot., datë 25.11.2025, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr.1665/2025, datë 13.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik dhe ka hartuar shtojcën, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62685-09-25-2025, me objekt: “Ndërtim Blloku Paskuqan 2”, me fond limit 107,003,399.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 13.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

I.3. Në datën 03.12.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.1777/2025 ku vendosi:

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62685-09-25-2025, me objekt: “Ndërtim Blloku Paskuqan 2”, me fond limit 107,003,399.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 13.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
2. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të publikojë shtojcën në zbatim të vendimit të sipërpërmendur.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.4. Me shkresën nr. 10683 prot., datë 05.12.2025, protokolluar me tonën nr. 2698/15 prot., datë 10.12.2025, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr.1665/2025, datë 13.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik dhe ka hartuar shtojcën, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62685-09-25-2025, me objekt: “Ndërtim Blloku Paskuqan 2”, me fond limit 107,003,399.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 13.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr.10683 prot., datë 05.12.2025, protokolluar me tonën nr. 2698/15 prot., datë 10.12.2025, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr.1665/2025, datë 13.11.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik dhe ka hartuar shtojcën, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62685-09-25-2025, me objekt: “Ndërtim Blloku Paskuqan 2”, me fond limit 107,003,399.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 13.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz..

II.2 Referuar informacionit të përcjellë nga autoriteti kontraktor me shkresën nr.10683 prot., datë 05.12.2025, protokolluar me tonën nr. 2698/15 prot., datë 10.12.2025, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet se autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën,në zbatim të vendimit Nr.1665/2025, datë 13.11.2025 të KPP.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-62685-09-25-2025, me objekt: “Ndërtim Blloku Paskuqan 2”, me fond limit 107,003,399.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 13.10.2025, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

